

Доц. дин Лиман *Вароши*, доц. дин Хусен *Шабанай*
(Университет “Александър Джувани” – Елбасан, Албания)

ВИЗАНТИЙСКАТА КРИЗА И РЕЛИГИОЗНИТЕ И ПОЛИТИЧЕСКИ КОНФЛИКТИ В АРБЪРИЙСКОТО ПРОСТРАНСТВО

Prof.as.dr. Liman *Varoshi*, Prof. as. dr. Hysen *Shabanaj*
Aleksander Xhuvani (University of Elbasan, Albania)
**THE BYZANTINE CRISIS AND THE RELIGIOUS AND
POLITICAL CONFLICTS IN THE ARBARIAN REGION**

After the fall of the Roman Empire, the regions inhabited by the Illirian population fall under the jurisdiction of the Byzantine Empire, but they keep their religious independence from The Pope in Rome. The two-sided dependence, material on the East and spiritual on the West, reflects on the political, military and religious development of the population in this regions for ages to come.

Being situated far from the central authority, on crucial thoroughfares connecting the East to the West, the Illirian population falls under the spiritual and moral influence of different kingdoms and empires. However, evolving during the Early Middle Ages to arbarian, they manage to survive, making good use of the geographical characteristics of the land with its narrow passes and valleys surrounded by harsh mountains, and thanks to the noteworthy tolerance towards foreign religions.

Keywords: Roman Empire; Byzantine Empire; Illirian population; Arbëria; arbëresh; Shqipëria; shqiptar.

KRIZA BIZANTINE DHE KONFLIKTET FETARE E POLITIKE NË HAPSIRËN E ARBËRISË

Ndarja e perandorisë Romake bëri që Prevalitania, Dardania, Epiri i Ri dhe Epiri i Vjetër, të banuar nga popullsi autoktone ilire, të mbeten nën juridiksionin e perandorisë Bizantine duke ruajtur vartësinë fetare me Papatin e Romës. Kjo vartësi e dyfishtë materiale nga Lindja e shpirtërore nga Perëndimi do të ketë pasoja në zhvillimet shumëshekullore politike, ushtarake e fetare të popullsisë së këtyre trevave.

E ndodhur në periferitë Veri-Perëndimore të Perandorisë Bizantine, larg vëmëndjes së pushtetit qëndror dhe Patrikanës së Kostandinopolit, midis rrugëve që dikur lidhnin fort Perëndimin me Lindjen nëpërmjet arterit kryesor rrugës Egnatia, popullsia Iliro-Latine në fillim, e më vonë e përzier me atë sllave e greke do të bëhet lakmi e vazhdueshme e perandorëve Bizantinë, carëve Bullgarë e Serbë dhe monarkëve të shteteve italice si dhe e përpjekjeve për mbi influencën shpirtërore e morale të kishave të tyre. Por pikërisht

në këtë nyje gardiane me epiqëndër territoret përfshi Epirin e Ri (Shqiptarët dhe trojet e tyre 1982: 203) duke përfutua edhe nga konfiguracioni gjeografik me gryka e lugina të rrethuara nga male të ashpra do të dijë të mbijetojë, ndër të tjera edhe në sajë të një tolerance të shkëlqyer fetare ndaj kishave të huaja, popullsia autoktone ilire që gjatë Mesjetës së Hershme do të evoluojë në atë arbëreshe. Aq e vërtetë kjo dukuri sa edhe në fillim të shekullit 14-të udhëtari anonim (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë 1982: 111) do të shkruante se “njerzit e këtyre provincave... nuk janë as thjeshtë katolik, as thjeshtë skizmatik...(e) e kanë një gjuhë të dalluar prej latinëve, grekërve dhe sllavëve....”.

Menjëherë pas ndarjes së Perandorisë Romake popullsia iliro-latine e Ilirikut do t'a pësojë shpesh nga dyndjet kalimtare të popujve “barbarë” e lëvizjet “skamare” që në fund të shekullit V përfshinë të gjithë Ilirikun (Istorijska srednjih vekov, Tom I 1952: 85). Grabitjet e popullsisë, rënia e jetës urbane e rrënim i ekonomisë do të ndërpriten përkohesisht në shekullin e VI e fillimin e shekullit VII, kohë kur, mbështetur në të dhënat burimore historike e sidomos ato arkeologjike, ndikimi i perandorisë Bizantine fuqizohet në trevat Ilire të cilat shndroheshin në krahina qendrore të kësaj perandorie. Në këtë kohë në këto treva vërehen ndërtime e rindërtime me karakter ushtarak e fetar (Skënder Anamali 1982: 106).

Ngritja e një sistemi të tërë fortifikimesh (Historia e Shqipërisë, VI 1967: 42) si dhe të një numëri bazilikash, babtistesh e kishash të cilat “flasin për një nivel mjaft të lartë ndërtimesh e për një lulëzim të mozaikut” (Skënder Anamali 1982: 107) tregojnë se shoqëria ilire e antikitetit të vonë dallohej për nivelin e lartë të qytetërimit e për një traditë kristjane të ngulitur mirë në ndërgjegjen e tij. Ky nivel i lartë zhvillimi si dhe lidhjet ekonomike shpirtërore të Ilirisë me Perëndimin ndikuan në ruajtjen e funksionimit e një rrjeti të gjere peshkopatash të cilat deri në fillimin e shekullit të VII, nëpërmjet metropolive të Shkodrës, Durrësit e Salonës ishin të lidhura me Romën (M. Shufflay 1926: 121). Ndërkohë në favor të këtyre zhvillimeve ishte edhe jeta pothuaj autonomiste që do të bënin këto treva në shekujt VII-VIII për arsye të shkëputjes me pushtetin perandorak si rezultat i futjes së popullsisë sllave e bullgare në Maqedoni e Thesali dhe i luftave të shpeshta që bënte me këto si dhe me arabët ky pushtet. Por kjo e mirë nuk zgjati shumë. Vala shkatërruese e dyndjeve sllave, sulmet bullgare e ato arabe deri në dyert e Kostandinopolit, gjatë shekullit të VIII e futën në një krizë të thellë Perandorinë Bizantine aq sa ajo doli jashtë loje në mbrojtjen e Adriatikut Lindor. Që nga kjo kohë popullsia e trevave Shqiptare do të përfshihet në vorbullën e ngjarjeve të shumta e të ngjeshura të konflikteve politike, ushtarake e fetare. Rrënja e jetës urbane e mbizotërimi i bashkësive fshatare që lidheshin vetëm me nënpunësit targambledhës perandorakë nëpërmjet pagimit të tributit kolektiv vjetor për shtetin, do të veshtirësojë më tej mbijetesën e ushtrimit të liturgjive fetare. Nën rrezikun e dyndjeve sllave e nën fuqitë e natyrës- vë në dukje Shufflay - u zhdukën në shekullin e VI-VII-të shumë qendra episkopale gjatë Adriatikut Lindor (M. Shufflay 1926: 125).

Politika e re kishtare që shpalli Luani i III Izauri me ediktin e luftës kundër adhurimit të ikonave më 726 i acaroi mardhëniet e tij me Papatin i cili me 731 thirri Sinodin Romak e hodhi poshtë këtë edikt, mallkoi ikonoklastët e vetë Leonin e III duke i shpallur armiq

të fesë e të kishës. Vendimet e këtij sinodi i mbështetën edhe kishat e manastiret e Shqipërisë (E. Çela 1991: 13). Kjo situatë e detyroi pera - ndorin e Bizantit që të shpallë vënien në vartësi të Patriarkanës së Kostandinopolit të të gjithë epishkopatat e ndodhur nën juridiksionin politik të tij në Itali e Adriatikun Lindor, me 732. Por tradita fetare përëndimore me të cilën ishte ushqyer kleri e popullsia e krishterë e trevave të Dalmacisë e Shqipërisë prej shekujsh, i bëri formale vendimet e Perandorit aq sa dhe kur u ndanë përfundimisht dy kishat, “në Jugë filluan carët bizantinë me i sundue metropolitë e në Veri papet e Romes “ - thotë Shufflay – (M. Shufflay 1926: 125).

Në rrethanat historike të krijuar në shekujt VIII-X, kohe kur shumica e trevave në Shqipëri bie nën stundimin e shtetit të fuqishëm Bullgar, Bizanti mezi ruan stundimin në temat e Durrësit e Nikorjës, të ndodhura gjithnjë nën trysinë Bullgare e Serbe. Ndërkohë Papatë përpigëj të bëhej sovran mbi sovranët e ishte i zënë me konflikte me perandorët Gjermanë e për pasojë pak interesohej për Adriatikun Lindor. Këto situata keqësuan më tej jo vetëm progresin ekonomik shoqëror të popullsisë autoktone shqiptare, tashmë të përzierë me popullsi sllave, greke e latine, por edhe traditën e tyre fetare. Megjithë situatën e krijuar vitaliteti i fituar prej shekujsh nga popullsia autoktone bëri që ajo të mbijetojë e të shënojë progrese. Siç ka konkluduar edhe historiani i madh Aleks Buda, në këtë periudhë popullsia autoktone sedentare njih një diferencim ekonomik-shoqëror, praktikon bujqësinë e zejtarinë, njih qëndra të tipit urban të vjetra e të reja (A. Buda 1982: 32).

Ndonëse të dhënat burimore e historike e ato arkeologjike janë tepër të varfra për gjendjen e kishave e aplikimin e riteve fetare për shek. VII-X mund të thuhet se duke filluar nga gjysma e II të shek. IX kemi një tërheqje e tkurrje të kishës Perëndimore drejt veriperëndimit e zgjerim të kishave bizantine e bullgare në kurriz të tyre. Ndërkohë që emrat e peshkopëve të Durrësit, Stefaniakës, Kunavisë përmenden në koncilet e fundshekullit të IX (A. Meksi 1982: 78), pak më vonë në aktet e sinodit Fotian nënshkruajnë peshkopët Luçiani i Durrësit, Kozmai i Stefaniakës, David i Krojës, dëshmi këto që tregojnë se edhe kishat e Shqipërisë së Mesme tashmë kalojnë sa në një rën ashtu edhe tjetrën influencë të kishave. Shufflay informon gjithashtu se ndërsa pushojnë së ekzistuari epishkopitë kryesore të Bylis, Apollonisë, Amntias fillojnë të shfaqen që në shek. IX autoritetet kishtare me emrat sllavë si Gradec, Bulgeropolis, Glavenica (M. Shufflay 1926: 124). Po rreth kësaj kohe - nënvizon ai - prej diogjezave kryesore qëndruan në tokën shqiptare Shkodra, Ulqini, Leshi, Kroja, Avalona e Durrësi (M. Shufflay 1926: 125). Nga këto të dhëna mund të dalin me mendimin se tokat e Temës së Durrësit, duke filluar në këtë kohë e jo më vonë, bëhen shesh konfliktesh e divergjencash midis tre kishave duke përfshirë edhe atë Bullgare. Ky konflikt bëhet më i ashpër pas vitit 870, kohë kur Koncili i eterve katolikë të mbledhur në Bizant votoi kundër pretendimeve të Papës, midis të tjerash, edhe lidhur me Kishën e re Bullgare duke i dhënë kështu mundësi Patriarkanës që të fusë këtë kishë nën vartësinë autonomiste të saj. (Corso di Storia; Il Medioevo 1980: 146).

Nisur nga të dhëna arkeologjike dhe disa të dhëna burimore historike si:

së pari: kultura e Komanit e cila nga 26 qëndra të zbuluara 24 i ka të identifikuar në zonën nga lumi Erzen në Jugë e deri në lumin Drin në Veri dhe nga Lumi Drini i Zi, në Lindje e brigjet e Adriatikut, në Perëndim. (S. Anamali 1982: 100); së dyti: dobësimi dhe

herë herë tkurra e Mbretërisë Bullgare pas vdekjes së car Simeonit më 927. (Historia e Shqipërisë. Vëllimi i parë 1982: 100); së treti: se Durrësi deri në fund të shekullit X ishte peshkopatë dhe “kishte nën vehte 15 epishkopi të tjera me kufinj jugorë Beratit e Aulonën e veriorë Tivarit dhe Ulqinit, epishkopitë e të cilëve – sipas Shufflay – i humbi në vitet 1020- 1022. (M. Shufflay 1926: 126); së katërti: se edhe gjatë sundimit të car Samuelit (957-1018) i cili krijoi Bullgarinë e Madhe – siç shkruan Gjergj Kedreni- “ deri në Trymale e në krahinat më të afërta me Serbinë e kishte pushtetin Ivan Vladimiri, dhëndëri i Samuelit, burrë i butë e paqësor. Falë virtyteve të tij punët e Durrësit ishin në qetësi (Burime tregtare për Shqipërinë 1975: 34).

Pra, nisur nga këto të dhëna, mund të konkludojmë se trevat ku shtrihet kultura e Romanit, jo vetëm që e vijuan jetën autonomiste të shekujve VII-VIII, por ishin dhe një shtrat i ngrohtë për zhvillimin ekonomik-shoqëror në këto trevave të kombësisë shqiptare të cilën autorë të ndryshë do t’u njohin me emrat albanoi, arbër e tje, gjatë shekullit XI. Jo pa influencë në këtë proces do të jenë, gjatë shekullit X, edhe konfliktet e armiqësitë midis kishave të Romës, Bizantit e Bullgarisë të cilat, në popullsinë shqiptare, ngjallnin ndjenjat e tolerancës fetare në aplikimin e riteve fetare herë të njerës e herë të tjetrës kishë. Kjo gjë i dha shkas faktit, ndonse ende të pa shkruar, që shqiptarët e këtyre trevave më parë ta quanin vehten arbër se sa latinë, grekë e bullgarë sipas rritit fetar që u imponohej në pëputhje me tkurrjen apo shtrirjen e kishave.

Në gjysmën e dytë të shekullit XI e gjatë gjithë shekullit XII trevat shqiptare u ndodhën nën trysinë e ngjarjeve kaq të ngjeshura politiko-ushtarake me mbarsje fetare sa është vështirë të rajvizosh influencat e konfliktet e kishave. Megjithatë, mund të themi se, në përgjithësi, trevat shqiptare kalojnë një periudhë dobsimi e mosbesimi ndaj rritit ortodoks e kishës bizantine, kjo për shkak të krizave të thella politike e financiare e për pasojë dhe ushtarake e fetare që kalon Bizanti (Istoria sredni vekov Tom I 1952: 229), të rritjes së ekspansionit politik e fetar të feudalëve dhe të kishës së Perëndimit e cila, pas ndarjes me atë të Lindjes më 1054, bëhet gjithnjë e më shumë agresive në brigjet e në brendësi të Ballkanit Perëndimor. Këtë e favorizonte edhe zhvillimi i qyteteve shqiptare e niderlandi i tyre që futen gjithnjë e më shumë në lidhje tregtare me qytetet e Perëndimit.

Supermacia e kishës së Perëndimit në raport me atë të Lindjes e cila, në Ballkan, goditej edhe nga lëvizja Bogomille, nga brënda, e nga kryqëzatat e sulmet Peçenege, nga jashtë, çoi në rritjen e ndikimit të katolicizmit në trevat veriore të Shqipërisë, zona këto, ku dhe ortodoksia nuk kishte rrënjë të thella. Këtë e favorizonte edhe kalimi i kroatëve dhe i popullsisë së shtetit serb të Zetës, që tashmë kishte pushtuar Prevalitaninë, në fenë katolike (Istoria sredni vekov Tom I 1952: 175). Peshkopata të tilla si ato të Shkodrës, Shurdhahut, Drishtit, Shasit, Ulqinit dhe Tivarit u shkëputën nga Metropolia ortodokse e Durrësit në shekullin e XI e, përmes kryepeshkopatës së Tivarit e cila varej nga ajo e Raguzës, lidhen me Romën (Historia e Shqipërisë V.I 1967: 176). Jo pa ndikim fetar katolik ishin dhe sulmet e Robert dhe Boemund Guiskardit, të Roxherit të Sicilisë, të kryqëzatës së Parë, Tretë e të Katër që inicoheshin nga papët e Romës (Dok. të perandorisë bizantine për historinë e Shqipërisë 1978: 44), të tregtarëve të shumtë perëndimorë si venedikas, amalfianë, raguzianë e tje, “ odiseja “ e heshtur e të cilëve kishte filluar kohë më parë drejt qyteteve bregdetare të Ballkanit Perëndimor (Pëllumb Xhufi 1989: 32).

Nga analiza që mund t'i bëjmë gjashtë bulave papale në adresë të peshkopëve të zonës nga Raguzë në Arbëri, dërguar gjatë shekullit XII, arrijmë në përfundime të tilla si: feja katolike gjithnjë e më shumë depërton drejt jugut sa që në vartësinë e Kryepeshkopit të Raguzës, kërkohet nga Papa Aleksandri i III, të futet dhe peshkopata e Arbërit (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë 1962: 58). Gjithashtu peshkopët katolikë të këtyre zonave, herë sipas traditës e herë sipas situatave politike aplikojnë ose ritet ortodokse ose ato katolike. Kjo argumentohet edhe me faktin se Papa e këshillon peshkopin Llazar të Arbërisë që të heqë dorë nga aplikimi i rritit grek “që duket se bie në kundërshtim me zakonet e kishës romake” (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë VI 1962: 58). Në fund të shekullit XII, më në fund, kishat e Shqipërisë Veriore shkëputen nga vartësia e peshkopatës së Raguzës e vartësohen nga Kryepeshkopata e Tivarit dhe e Dioklesë (M. Shufflay 1926: 130). Jo vetëm kaq por, me vendimet e Kocilit të Tivarit (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë VII 1962: 59), nën presionin e fuqishëm të Papatit, ato pranojnë të gjitha kërkesat e Kushtetutës së etërve të shënjtë të rritit katolik.

Gjatë shekujve XIII-XIV, ndonëse situatat politike e ushtarake janë tepër të ngjeshura me ngjarje, në trojet shqiptare fillojnë të marrin një karakter gjithnjë e më të qëndrueshëm zonat e shtrirjes së influencave të kishave katolike, ortodokse, bullgare e serbe. Kjo e fundit shpallet autonome në vitin e 13 të sundimit të Stefan Dushanit.

Kisha katolike zë shtrat më të qëndrueshëm në rajonet nga Tivari e deri në Krujë e Çermënikë. Në këto zona, të cilat, sikurse shpjegon relacioni i kryepeshkopit të Tivarit, Guliam Adam, janë të banuara nga shqiptarët, ku rreth 10 qytete së bashku me dioqezat e tyre “janë të rritit katolik dhe i rezistojnë me guxim zgjedhës së padurueshme e tepër të rëndë të sunduesve sllavë.” (Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë VI 1962: 111-112). Ato i shëtojnë njëherë e mirë ndikimit të kishës serbe në gjysmën e dytë të shekullit XIV kur sundohen tashmë nga princër shqiptarë. Në vitin 1369, me kalimin e ballshajve në anën e kishës katolike, lidhjet me sllavët ortodoksë u dobësuan edhe më tepër, kurse, komunikimi politik e fetar me shqiptarët katolikë u forcua edhe më tej. (K. Frashëri 1962: 16).

Një shtrirje më të gjërë zë kisha katolike edhe në Shqipërinë bregdetare nga Lezha e deri në Vlorë. Krijimi i Dukatit të Durrsit nga Venediku më 1205, depërtimi i anzhuinëve që krijuan “Mbretërinë e Arbërit” në vitet 1272-1286, rikrijimi i saj nga Filipi i Tarentit si dhe lidhjet e anzhuinëve me Andrea Muzakën e Tanush Topinë në gjysmën e parë të shekullit XIV, bënë që, më në fund, tokat në Veri të lumit Shkumbin të futen nën ndikimin e kishës katolike. Ndërsa në rajonet nga Durrësi, Myzeqe e Vlorë besimi ortodoks tronditet e herë herë jeton me atë katolik. Personifikimi i këtyre luhatjeve është dhe vetë sundimtari i këtyre trevave Karl Topia që gjatë gjithë sundimit, në përputhje me interesat e tij, lëkundej midis dy riteve; mbi bazat e një manastiri benediktian ndërton një manastir ortodoks për hir të një martiri popullor siç ishte Shën Gjon Vladimiri, ku, ndonëse ishte më shumë katolik kërkon të varroset edhe vetë.

Në rajonet e pellgut të Kosovës e deri në Dibër e Kërçovë do të vazhdojë të dominojë feja ortodokse që tani merr më shume nuanca sllave të cilat me vështirësi pranohen nga popullsitë jo sllave siç ishin dhe shqiptarët. Ndryshe qëndron problemi i besimit fetar në pellgun që shkon nga Ohri e Prespa e deri në Prevesë e Janinë pasi këtu

jo vetëm që dominon besimi fetar ortodoks por dhe ngulitja e ritualeve fetare ortodokse në ndërgjegjen e njerzve është e vullnetshme pasi aty ka pasur mbizotërim shumëshekullor të kishës bizantine e asaj bullgare.

LITERATURA

- Shqiptaret dhe Trojet e Tyre.** Botim i Akademisë së Shkencave. Tiranë. 1982.
- Burime të Zgjedhura për Historinë e Shqipërisë.** V. II. Tiranë. 1982.
- Istoria Sredni Vekov.** Tom. I. Moska. 1952.
- Anamali, 1982:** Anamali, S. Nga Ilirët tek Arbërit. Shqiptarët në Trojet e Tyre, Tiranë, 1982.
- Historia e Shqipërisë.** Vëllimi i I, Tiranë 1967.
- Shufflay, 1926:** Shufflay, S. Serbët e Shqiptarët, Tiranë, 1926.
- Çela, 1991:** Çela, E. Traditat afetare të popullit Shqiptar, Tiranë, 1991.
- Buda, 1982:** Buda, A. Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar të gjuhës e kulturës së tij. Shqiptarët dhe Trojet e Tyre, Tiranë, 1982.
- Meksi, 1978:** Meksi, A. Kishat mesjetare të Shqipërisë së Mesme e të Veriut në: Monumente Nr. 2, Tiranë, 1978.
- Dokumenta të periudhës bizantine për Historinë e Shqipërisë (VII-XV).** Tiranë. 1978.
- Corso di Storia.** Il Medioevo, vol. I, Torino. 1980.
- Historia e Shqipërisë.** Vëllim i I, Tiranë. 1967.
- Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë.** Tiranë. 1975.
- Xhufi, 1989:** Xhufi, P. Studime për epokën e Skënderbeut-VI, Tiranë, 1989.
- Fashëri, 1962:** Frashëri, K. Trojet e Shqiptarëve në shek. XV-në: studime për epokën e Skënderbeut. V. I, Tiranë, 1962.